36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **612-26-5298-5-2-1/C711**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 24,989.75 EUR , në afat prej 30 ditësh pas implementimit të kontratës ndersa pas perfundimit të punimeve dhe pranimit të tyre nga menaxheri i kontratës, kontraktuesi duhet të depozitojë sigurimin e performances/përmbushjes në vlerë prej 10 % nga vlera e punimeve të realizuara si garancë për kualitetin dhe cilësinë e punëve , materialeve dhe për të përmirësuar defektet eventuale të paraqitura gjatë periudhës garantuese.Kjo periudhë garantuese duhet të jetë 12 muaj nga data e përfundimit të punimeve.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK-se , kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me kontratën shuma minimale është 15 000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: i. të punëtorëve të Kontraktuesit: 50 000 euro për çdo ndodhi kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; ii. të personave të tjerë: 50 000 euro për çdo ndodhi kurse numri i ndodhive është i pakufizuar;
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 10 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar ne Planin e Menaxhimit nga menaxheri i kontratës.

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas dinamikës së punëve dhe arsyeshmerisë së vonësave të lejuara nga menaxheri i kontratës kurse afati për përfundimin e punëve është 65 ditë pune.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Kërkohet nga kontraktuesi evidenca e punëve të kryera në ditarin e punës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim nga ZKA-ja.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/AEUR
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>N/A</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 65 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Perioda garantuuese e defekteve është 365 ditë.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është 10 %.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do të përpiqen që çdo mosmarrëveshje në mes tyre ta zgjidhin në mënyrë miqësore nga Menaxheri i Kontratës, personave përgjegjës të AK si dhe personave përgjegjës të autorizuar nga kryesi i punëve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Ndërtimi i parqeve, hapësirave të reja rekreative, dhe këndi i lojrave nëpër vendbanime në: Fushë Kosovë rr."Amir Elmazi", rr. "Vllezërit Majaci"					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA - Parku 01					
rr."Amir Elmazi"					
1 Punët përgatitore					
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1	Matja dhe ruajtja e pikave gjeodezike, sipas Projektit.	komplet	1.0	2,520.00 €	2,520.00 €
1.2	Të bëhet pastrimi i terenit prej materialeve të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, si: heqja e shkurreve, heqja e gurëve, kubëzave, skajoreve të asfaltit, betoneve, rrethojave egzistuese dhe gjitha mbeturinave që ndodhen në sipërfaqe të terrenit të parkut. Njëherit materiali i grumbulluar parashihet të dërgohet/transportohet deri në deponi, sipas Menaxherit të Kontratës.	komplet	1.0	2,520.00 €	2,520.00 €
1.3	Sigurimi i vendpunishtes në tërë perimetrit e parkut	komplet	1.0	2,520.00 €	2,520.00 €
				Shuma 1:	7,560.00 €
2 Punët e Gërmimit dhe nivelizimit					
		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1	Gërryerja e bazës së parkut në komplet sipërfaqet . Duhet të bëhet largimi i materialit, nivelizimi i saj, pra heqja e shtresës së tokës mes 20cm. Dheu i gërryer nëse është kualitativ duhet të planifikohet të shpërndahet mbrenda pozicionit të parkut, nëse për nga kualiteti është i dobët duhet të transportohet deri në deponi, sipas udhëzimeve të Menaxherit.	m ³	340.00	7.00 €	2,380.00 €
2.2	Gërmimi i terenit në pjesët: e shtigjeve të këmbësorëve, këndit të lojrave, në këto sipërfaqe të cekura gërmimi duhet të bëhet d=30cm, varësisht prej nevojës së arritjes së nivelit të përshtatshëm. Llogaritet edhe nivelizimi i këtyre sipërfaqeve. Dheu i gërryer duhet të planifikohet të shpërndahet mbrenda pozicionit të parkut, por nëse për nga kualiteti është i dobët duhet të transportohet deri në deponi.Sipas udhëzimeve të menaxherit.	m ³	180.00	7.00 €	1,260.00 €
2.3	Furnizimi, transporti, shtruarja, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës humusore, i dheut kualitativ, në pjesët e parapara për gjelbrim. Me qëllim të formësimit të nivelit të sipërfaqes.	m ³	380.00	5.00 €	1,900.00 €
				Shuma 2:	5,540.00 €

3	Punët e mbushjes dhe zhavorit				
		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
3.1	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion Ø 0-63mm për punimin e bazamentit të shtigjeve të këmbësorëve, këndit të lojrave, me trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur. Llogaritet edhe ngjeshja e zhavorit me cilindër. Ngjeshja e zhavorit duhet të bëhet në shtresa.	m ³	125.0	17.00 €	2,125.00 €
3.2	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion Ø 0-31.5mm për punimin e bazamentit të shtigjeve të këmbësorëve, këndit të lojrave, me trashësi t=10cm në gjendje të ngjeshur. Llogaritet edhe ngjeshja e zhavorit me cilindër. Ngjeshja e zhavorit duhet të bëhet në shtresa. Ngjeshja te këndi i lojrave duhet të arrijë koficientin mbi 60 MPa, ndërsa mbi 50 MPa te shtigjet e këmbësorëve.	m ³	62.0	17.00 €	1,054.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe planifikimi mbi zhavorin e ngjeshur (të shtigjeve të këmbësorëve) i gurit të bluar 4-8mm, me trashësi t=5cm, për vendosjen e kubzave.	m ³	10.00	17.00 €	170.00 €
3.4	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe shtruarja e zhavorit dekorativ -ngjyrë të bardhë, me fraksion Ø 31.5-63mm (në pozicionet rreth trungut të pemëve-që nodhen në projekt) trashësi t=10cm.	m ³	10.00	25.00 €	250.00 €
OE është obligativ, para shtruarjes së kubézave, ta bëjë (A testin) e ngjeshmërisë në shtigje të këmbësorëve dhe në kënd të lojrave. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.					
				Shuma:3	3,599.00 €

4 Kubëzat e betonit dhe shtruarja e betonit					
		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i skajorëve nga betoni me dimensione 8x20x100cm, për skaj të parkut.	m'	100.00	15.00 €	1,500.00 €
4.2	Furnizimi transporti dhe vendosja e pllakave të terase Terastone granili (0-4)mm nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Kuarc, Granit, Diabaz, Bazalt)etj. e kalibruar,e gerryer, e rrezuar dhe impregnaur me tehe chamfer, ngjyre dhe granulat sipas kerkeses se menaxherit te kontrates , detalit ne projekt.				
	Pllaka terastone eshte 40x20x6 cm(ose me dimensione sipas kerkeses se menaxherit te kontrates nga AK) e kalibruar,e gerryer, e rrezuar dhe impregnaur me tehe chamfer, Ne vlera referuese te Standardeve Evropiane EN 13748-2:2004. Pllaka per perdorim ne hapsira te hapura ne ambiente te jashtme. Montimi i materialit duhet ti permbahet udhezimeve teknike per kete lloj materiali dhe gjithmone sipas udhezimeve te Projektantit, prodhuesit si dhe organet mbikqyres per dizajn dhe ngjyre. Materiali i granitit nga guret natyralohet me keto pika te veqanta:				
	Prodhuesi te jete i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per system hermetik te makinerise prodhuese.				
	Produkti te plotesoj standardet ne vazhdim: EC (Declaration of Conformity) Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD(Construction Product Directive) dhe EN 13748-2				
	Per pllaka per perdorim ne hapsira te hapura apo ambiente te jashtme. Pastrimi i lartëve me frekuentim të lartë, Rezistenca ndaj ngricave dhe kripës me standarde të ngjashem te EU. Absorbimi i ujit nga kapilarët, Rezistenca ndaj rrëshqitjes (USRV) ,Rezistencë e shkalles ndaj ujit vërtet gërryrjeve, Ekspozimi ndaj makinave fshirëse, Qëndrimi ndaj detergjentëve, Shkalla e shumë largimit të gomave përtypëse, Rezistenca ndaj tensionit të lartë të energjisë elektrike. Easy-to-Clean (për pastrimin e ngjyrave, balta, gjerat ushqimore, reshjet natyrore, vajrat e ndryshme dhe duhet të largohen me duke mos lejuar të tjera.) te gjitha njollat rezistuese duhet te largohen me uje dhe fshese vetem me nje trajtim. Vërejtje:Te gjitha pikat e shenuara me larte te deshmoen me ateste te veqanta te standardeve DIN ose te EU-se. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektin dhe ne udhezim te organizimit mbikqyres. Vërejtje: Materiali duhet të posedoj ateste të çertifikuar me shenjen CE				
	Mbushja e fugave me material HUESLER apo BAUMIT travertine per perdorim te jashtem me efektenues duke mos lejuar keto e barite dhe duke percuar pllaken me njera tjetren. Gjeresia e fuges duhet te jete 3 mm sipas detalit ne projekt . Sasia e llogaritur materialit te fuges 1.0 kg/m2				
	Furnizimi I Pllakave sipas pershkrimit me Lart per Trotuare. Vërejtje: Në këtë pozicion është përfshirë edhe rregullimi i sipërfaqes së drurit dekorativ sipas kërkesave të AK. Tek te gjitha lidhjet e rruges me rruget dytesore dhe rampat duhet kene pjerrtesi 5%, ne forme te rampave.	m²	190.00	40.00 €	7,600.00 €

4.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kalldrëmit (kubëzave) nga guri natyror i perpunuar në formë kubike, me dim 10x10x8 cm, për formimin e brezave dekorativë dhe kufizues përgjatë sipërfaqeve të gjelbra, shtigjeve të këmbësorëve dhe këndit të lojërave. Kalldrëmi do të vendosen mbi shtresë betoni gjysme të lëngshëm, në mënyrë të ngjashme me vendosjen e skajorëve të trotuareve, duke siguruar qëndrueshmëri, nivelim të rregullt dhe vijëzim sipas projektit. Të gjitha materialet, transporti, puna, mjetet e nevojshme dhe elementet ndihmëse përfshihen në pozicion. Dizajni dhe mënyra e vendosjes së kubëzave do të përcaktohen dhe miratohen nga organi mbikëqyrës para ekzekutimit të punimeve.	m'	180.0	5.00 €	900.00 €
4.4	Furnizimi, transporti, shtrirja e shtresës së shtegut me beton C30/37 sipas projektit. Në pozicion të përfshihet edhe vendosja e kallëpëve anësorë dhe punimi i betonit me trashësi 8+5 cm si dhe vendosja e rrjetës së çelikut Fi8 (15x15cm) në sipërfaqen e pare bazë (8cm). Sipërfaqja përfundimtare si shtresë e dyte me trashësi t=5 cm të trajtohet me gurë dekorativ të pastërt të inkorporuar në shtresën e betonit me ngjyrë dhe granulacion sipas përzgjedhjes së organit mbikëqyrës. Punimet të përfshijnë edhe fugimin, vendosjen e profileve të çelikut të zinkuar, cdo sipërfaqe max. 25 m², përpunimin e skajeve me profile të zinkuara, pastrimin dhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme për realizimin e plotë të pozicionit. Vërejtje: Betoni C30/37 duhet të përmbajë aditiv superplastifikues + waterproofing për zvogëlimin e ujëpërshkueshmërisë, në dozë minimale 3.5 kg/m³ (ose sipas rekomandimit të prodhuesit), duke siguruar absorbim të ulët të ujit dhe rritje të qëndrueshmërisë ndaj lagështisë dhe cikleve ngrirje-shkrirje.	m ²	250.0	55.00 €	13,750.00 €
	Furnizimi, transporti, kallëpimi, armimi dhe betonimi i mureve të ulëta nga betoni i armuar C-30 për formimin e rrethimit të gjelbrimit të ngritur, me lartësi 40 cm mbi nivelin e terrenit dhe gjerësi 15 cm sipas projektit. Punimet përfshijnë gërmimin lokal sipas nevojës, përgatitjen e bazamentit, vendosjen e armaturës, kallëpimin në të dy anët, trajtimin e sipërfaqeve të ekspozuara dhe realizimin e nyjeve të nevojshme. Përfundimi i murit të jetë me sipërfaqe të lëmuar ose me trajtim dekorativ sipas përzgjedhjes së organit mbikëqyrës. Pozicioni përfshin gjithashtu mbushjen prapa murit, pastrimin dhe të gjitha materialet, pajisjet dhe punët e nevojshme për realizimin e plotë të pozicionit.	m'	85.0	130.00 €	11,050.00 €

Furnizim, transporti dhe montim i murit mbrojtës në formë "L" (Muri i parafabrikuar), i realizuar nga beton i armuar me dimensione H-60 cm, t-12cm, L-100 cm. Elementi përbëhet nga pjesa vertikale mbajtëse e dheut dhe bazamenti stabilizues në formë L, i projektuar për përballimin e presionit të tokës dhe ngarkesave të jashtme. Punimi përfshin përgatitjen e nënshtresës, nivelimin dhe ngjeshjen e terrenit, vendosjen e shtresës përgatitore (zhavorr i imët ose beton i varfër nëse kërkohet), vendosjen me vinç ose pajisje të përshtatshme të elementeve L në pozicionin e saktë sipas projektit, rreshtimin dhe fiksimin e tyre, si dhe mbushjen anësore me material të përshkueshëm (drenues) për të siguruar stabilitet dhe largim të ujërave. Përfshihet gjithashtu realizimi i fugave ndërmjet elementeve me aplikimin e primer bitulit dhe finalizim me izolim me flakë t=4mm, materiale lidhese nëse kërkohen, si dhe të gjitha punët ndihmëse deri në përfundimin e plotë të pozicionit.	copë	80.0	130.00 €	10,400.00 €
Verejtje: Para fillimit të cdo betonimi, kontraktori obligohet të njoftojë dhe të sigurojë praninë e laboratorit të autorizuar për kontrollin e cilësisë së betonit.				
Shuma:4				45,200.00 €

5 Mobilari urban					
		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
5.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i ulëseve nga materiali: betonit, drurit dhe hekurit. Në llogari hynë komplet punimi i ulëseve sipas vizatimit, duke përfshi furnizimin dhe punimin e murit të ulëseve me beton arme, furnizimin dhe punimin e listelave drunore, furnizimin dhe punimin e profileve metalike , të gjitha këto sipas projektit të bashkangjitur, parashihet edhe furnizimi dhe lyerja e ulëseve me material për mbrojtje kundër lagështisë, insekteve, këpurdhave si dhe lyerje përfundimtare, dhe të gjitha elementeve tjera përcjellëse për fiksime: bulonave, pllakave, etj. Punëkryesi obligohet që para vurjes në vepër të marr aprovimin nga ana e organit mbikëqyrës. Modeli, dizajni i karrikave të jetë në përputhje me dimensionet në projekt. 	m'	35	100.00 €	3,500.00 €
5.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i ulëseve nga druri dhe metali. Në llogari hynë komplet punimi furnizimi dhe ankerimi i ulëseve, të gjitha këto sipas projektit të bashkangjitur, parashihet edhe furnizimi dhe lyerja e ulëseve me material për mbrojtje kundër lagështisë, insekteve, këpurdhave si dhe lyerje përfundimtare, dhe të gjitha elementeve tjera përcjellëse për fiksime: bulonave, pllakave, etj. Punëkryesi obligohet që para vurjes në vepër të marr aprovimin nga ana e organit mbikëqyrës. Modeli, dizajni i karrikave të jetë në përputhje me dimensionet në detal skicë. 	copë	8	400.00 €	3,200.00 €

5.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i shportave për mbeturina. Ai realizohet me konstruksion të salduar nga llamarinë çeliku me trashësi 3 mm dhe 4 mm (kapaku), si dhe 2 mm për pjesën e tavlës, së bashku me tuba çeliku me diametër 13 mm. Prodhet nga çelik karboni S235JR i galvanizuar dhe i lyer me bojë pluhur në ngjyrë RAL të përzgjedhur, duke siguruar rezistencë të lartë ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike. Shporta është e pajisur me enë të brendshme të galvanizuar me trashësi 0.8 mm dhe kapacitet 60 litra, si dhe me tavllë cigareje me kapacitet 0.5 litra. Hapja realizohet me çelës, duke mundësuar mirëmbajtje dhe zbraze të lehtë dhe të sigurt. Të gjitha elementet duhet të ankorohen në mënyrë të duhur sipas udhëzimeve teknike të prodhuesit. Lartësia 81 cm 	copë	14	200.00 €	2,800.00 €
5.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i mbrojtëseve të gjelbrimit. Realizohet nga çelik karboni S235JR me trashësi 10 mm, i galvanizuar dhe i lyer me bojë pluhur, duke siguruar rezistencë të lartë ndaj korrozionit, ngarkesave mekanike dhe kushteve atmosferike. Grila është e disponueshme në dimensione Ø120, ndërsa diametri i hapjes për trungun e pemës është 50–80 cm, duke mundësuar përshtatje për lloje të ndryshme instalimesh urbane. Trashësia e grilës është 10 mm, ndërsa trashësia totale përfshirë kornizën është 60 mm, duke garantuar qëndrueshmëri dhe kapacitet të lartë mbajtës. Materiali kryesor është çelik karboni me trashësi 10 mm, i projektuar për përdorim intensiv në ambiente publike. Montimi realizohet sipas udhëzimeve teknike, duke siguruar stabilitet dhe fiksion të sigurt në bazament. 	copë	8	150.00 €	1,200.00 €

5.5	Furnizimi transporti dhe montimi i ulëses të parafabrikuar me strukturë çelik karboni S235JR i galvanizuar dhe i lyer me bojë pluhur sipas paletës RAL e kerkuar nga organi mbikqyrës, duke siguruar rezistencë të lartë ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike. Pjesa e uljes dhe mbështetëses përbëhet nga dërrasa druri natyral me seksion drejtkëndor 38 x 100 mm. Ulesja përmban 18 dërrasa me gjatësi të ndryshme nga 466 mm deri në 705 mm, ndërsa mbështetësja e shpinës realizohet nga një dërrasë e vetme me dimensione 48 x 140 x 2170 mm. Druri duhet të jetë i impregnuar, dru i fortë dhe i trajtuar me vaj, duke ofruar qëndrueshmëri dhe estetikë natyrale. Dimensionet e përgjithshme të ulëses janë: lartësia 74 cm, lartësia e uljes 45 cm, gjerësia 276 cm dhe thellësia 87 cm. Pesha është rreth 152 kg për variantin me dru të fortë. Struktura metalike është realizuar nga llamarinë çeliku me trashësi 2–8 mm, duke siguruar qëndrueshmëri të lartë dhe stabilitet në përdorim publik. Materialet përbëhen nga çelik karboni dhe dru natyral (i fortë), duke bërë produktin të përshtatshëm për ambiente urbane me përdorim intensiv.	copë	2	2,000.00 €	4,000.00 €
	Verejtje: Mostrat të aprohohen para se të bëhet porositja.				
				Shuma:5	14,700.00 €

6	Lojrat për këndin e fëmijëve				
	Lodrat duhet të jenë të parafabrikuara në përputhshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO.	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
6.1	Furnizimi, transporti, montimi i lodrave "Play structures", për fëmijë 3-14 vjet, lartësia e lirë e rënjes 200 cm. (Në çmim llogaritet edhe furnizimi dhe montimi i gomave rrethore në pjesën e poshtme të strukturës së lodrës, sikur në foto). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional duke përfshirë gërmimin e gropave, furnizimin/shtruarjen e zhavorit për bazament të themlit, furnizimin/betonimin e themeleve nga betoni i armuar, furnizimin/lakimin/montimin e armaturës si dhe furnizimin/montimin/ankerimin me ankera special - të gjitha këto në tërësi sipas udhëzimit dhe standardeve të prodhuesit. Lodra duhet të korrespondojë me foton dhe me dimensionet e bashkangjitur në projekt, 	copë	1	4,000.00 €	4,000.00 €
6.3	Furnizimi, transporti, montimi i lodrave "SEESAW", për fëmijë 3-12 vjet, lartësia e lirë e rënjes 70 cm. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional duke përfshirë gërmimin e gropave, furnizimin/shtruarjen e zhavorit për bazament, furnizimin/betonimin e themeleve nga betoni i armuar, furnizimin/lakimin/montimin e armaturës si dhe furnizimin/montimin/ankerimin me ankera special - të gjitha këto në tërësi sipas udhëzimit dhe standardeve të prodhuesit. Lodra duhet të korrespondojë me foton dhe me dimensionet e bashkangjitur në projekt. 	copë	1	750.00 €	750.00 €

6.4	Furnizimi, transporti, montimi i lodrave "SPRINGERS 01", për fëmijë 2-6 vjet, lartësia e lirë e uljes 55 cm. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional duke përfshirë gërmimin e gropave, furnizimin/shtruarjen e zhavorit për bazament të themlit, furnizimin/betonimin e themeleve nga betoni i armuar, furnizimin/lakimin/montimin e armaturës si dhe furnizimin/montimin/ankerimin me ankera special - të gjitha këto në tërësi sipas udhëzimit dhe standardeve të prodhuesit. Lodra duhet të korrespondojë me foton dhe me dimensionet e bashkangjitur në projekt. 	copë	2	600.00 €	1,200.00 €
6.5	Furnizimi, transporti, montimi i lodrave "Play house - 85kg", për fëmijë 2-6 vjet, lartësia e lirë e rënjes: 170mm. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional duke përfshirë gërmimin e gropave, furnizimin/shtruarjen e zhavorit për bazament, furnizimin/betonimin e themeleve nga betoni i armuar, furnizimin/lakimin/montimin e armaturës si dhe furnizimin/montimin/ankerimin me ankera special - të gjitha këto në tërësi sipas udhëzimit dhe standardeve të prodhuesit. Lodra duhet të korrespondojë me foton dhe me dimensionet e bashkangjitura në projekt. 	copë	1	600.00 €	600.00 €
Shuma :6					6,550.00 €

7 Dyshemeja prej gome					
		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
7.1	Furnizimi, transporti dhe shtruarja e betonit C30/37 me trashësi 8cm dhe rrjetë të çelikut Fi8 (15x15), duke punuar dilatimet e nevojshme me modul (për këndin e lojrave). Betonit ti shtohet aditivi per rezistence ndaj lageshtisë. Ti kushtohet kujdes nivelimit dhe evitimit te gropave dhe deformimeve gjate betonimit.	m ³	15.00	200.00 €	3,000.00 €
7.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i dyshemesë prej gome me trashësi 20 mm për fazën e parë , Materiali gomë e zezë SBR e aplikuar me ngjitës adekuat për shtresën e parë . Në kuadër të këtij pozicioni llogaritet edhe furnizimi/transporti/ shtruarja e ngjitësit poliretan. Produkti duhet ti plotësojë standared. Të ofrohet garancioni në realizim (min.3 vite). Kjo dysheme punohet te këndi i lojrave shtresa e parë .	m ²	180.00	20.00 €	3,600.00 €
7.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i dyshemesë prej gome me trashësi 10-13 mm shtresa e dytë : Materiali granualt gome poliuretan EPDM :0,5 - 1,5 mm . Kjo llojë gome duhet të jetë me ngjyrë (ngjyra caktohet nga organi mbikqyrës i projektit) Produkti ti plotësojë standaredt DIN V 18035-6, EN-14 977, IAAF ose të ngjajshme. Trashësia shtresës së granualtit EPDM duhet të jetë nga 10 deri 13 mm. Të dyja shtresat e dyshemesë të jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjitësat adekuat. Ky pozicion të realizohet medeomos nga stafi profesional i trajnuar per realizim të produktit dhe në terësi sipas udhëzimeve të prodhuesit (temp. minimale dhe temp. maksimale gjate realizimit, lagështia e ajrit, kunder rrezeve UV etj.)përfshirë edhe pastrimin paraprak të bazës dhe pregaditjen e nënbazës. Te ofrohet garancioni në prodhim/material (min. 5 vite) dhe në realizim (min. 2 vite). Obligim i punëkryesit është sigurimi i materialit dhe prodhimit gjate realizimit dhe mbrojtja nga ndikimet atmosferike (të reshurat, dielli etj.). Kjo dysheme punohet te fusha e lodrave për fëmijë.	m ²	180.00	20.00 €	3,600.00 €
7.4	Furnizimi , transporti dhe aplikimi i një shtrese me ngjyrë mbi shtresën finale, shtresa me bojë adekaute dy komponentëshe prej Poliuretani e mbron shtresën finale nga dielli dhe rrezet UV e cila e ruan freskin e ngjyrë për së paku 3 vite. Ngjyra te jete e prodhuar ose aprovuar nga i njejt prodhues i sistemit.	m ²	180.00	10.00 €	1,800.00 €
Shuma :7					12,000.00 €

8	Gjelbrimi				
		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
8.1	Furnizimi, transporti dhe mbjellja me farë kualitative në sipërfaqet e parapara për gjelbrim. Si dhe rrafshimi me ngjeshje me cilindër të dorës/kopshtarit prej 50-60 kg.	m ²	960.0	1.00 €	960.00 €
8.2	Furnizimi me drunj dekorativ të llojit: "ACER Variegatum" dru gjethërës. Perimetri i trungut të jetë 18-20 cm, matja të bëhet në 100 cm lartësi nga toka. Fidanet duhet të kenë dëshmi për prejardhje (certifikata e origjines). Në çmim llogaritet mirëmbajtja e gjelbrimit të lartë me ujitje, ose rikultivimin e sërishëm nëse mbjelljet dështojnë.	copë	29	50.00 €	1,450.00 €
8.3	Furnizimi,transporti dhe mbjellja e drunjëve të llojit: "Populus Nigra"Italica"(Plepi Italian)". Perimetri i trungut 12-14 cm, matja të bëhet në 100 cm lartësi nga toka. Në çmim llogaritet mirëmbajtja e gjelbrimit të lartë me ujitje, ose rikultivimin e sërishëm nëse mbjelljet dështojnë.Fidanet duhet të kenë dëshmi për prejardhje	copë	5	50.00 €	250.00 €
8.4	Furnizimi transporti dhe mbjellja e shkurreve dekorative "Nandina Domestica" . Lartësia h=40-60 cm, me diameter të kurorës 30-50 cm. Në çmim të llogaritet mirëmbajtja me ujitje, ose rikultivimin e sërishëm nëse mbjelljet dështojnë. Fidanet duhet të kenë dëshmi për prejardhje (certifikata e origjines)	copë	150	50.00 €	7,500.00 €
Shuma :8					10,160.00 €

9	Sistemi I ujitjes				
9.1	Hapja e puseve për sistemin e ujitjes, furnizimi dhe vendosja e gypave të betonit Ø 800 mm, përfshirë drenazhimin, largimin e materialit të gërmuar dhe të gjitha punët e nevojshme për funksionalizimin e plotë të pusit.	m'- thellesi	36.00	50.00 €	1,800.00 €
9.2	Furnizimi, montimi dhe vënia në funksion e pajisjes elektronike (kontrollerit) për komandimin dhe startimin automatik të sistemit të ujitjes me 8 stacione, përfshirë programimin bazik dhe testimin e sistemit.	copë	2.00	200.00 €	400.00 €
9.3	Furnizimi, montimi dhe pozicionimi i spërkatësve të tipit Rotor, seria 5000+ ose ekuivalente, në sipërfaqet e gjelbra. Pozicionimi i saktë i spërkatësve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktues (AK). Çmimi përfshin të gjitha lidhjet dhe materialet përcjellëse për instalim	copë	40.00	10.00 €	400.00 €
9.4	Furnizimi, montimi dhe pozicionimi i spërkatësve të tipit Spray, seria PS Ultra 16 VAN ose ekuivalente, në sipërfaqet e gjelbra. Pozicionimi i saktë do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktues (AK).	copë	20.00	10.00 €	200.00 €
9.5	Furnizimi dhe vendosja e gypit përcjellës PEHD (Alkaten), presioni 16 bar, për furnizimin me ujë të spërkatësve dhe elementeve të tjera të sistemit të ujitjes, përfshirë të gjitha punët e montimit dhe testimit.				
9.5.1	PEHD Ø50 mm PN16 - Nga pompa deri te kolektori kryesore dhe nga linja kryesore në park	m'	88.00	2.00 €	176.00 €
9.5.2	PEHD Ø32 mm PN16 -Degët për secilën zonë dhe lidhja e ventilin me roret	m'	370.00	2.00 €	740.00 €
9.5.3	PEHD 25 mm (¾") - Lidhjet individuale	m'	90.00	2.00 €	180.00 €
9.6	Furnizimi dhe vendosja e ventileve elektrike (solenoid) Ø 1", të përshtatshme për sistem automatik të ujitjes, përfshirë montimin, lidhjen dhe testimin funksional.	copë	10.00	3.00 €	30.00 €
9.7	Furnizimi dhe vendosja e lidhësve PVC (reduksione dhe aksesore lidhës) 1" x ¾", për lidhjen e spërkatësve me rrjetin kryesor të ujitjes.	copë	40.00	3.00 €	120.00 €
9.8	Furnizimi dhe vendosja e kutive mbrojtëse standarde për ventile, rezistente ndaj ujit dhe kushteve atmosferike, përfshirë të gjitha materialet ndihmëse dhe shpenzuese si: lidhëse, teflon, kablllo elektrike, konektorë, priza, kontaktorë dhe pajisje të tjera të nevojshme për funksionimin e sistemit	copë	1.00	50.00 €	50.00 €

9.9	Furnizimi, transporti dhe montimi i pusëtës për pompë qarkulluese me dimensione 180x180x160 cm, duke përfshirë kapakun prej betoni të armuar, kornizën dhe kapakun prej gize. Në çmim përfshihen gërmimi, nivelizimi i bazës, betonimi me beton C20/25 të armuar me rrjetë çeliku, si dhe të gjitha punimet e nevojshme për realizimin e plotë të pusëtës. Puseta duhet të hidroizolohet nga jashtë me membranë bituminoze të aplikuar me flakë dhe nga brenda me hidroizolim adekuat. Për shkak të pranisë së pajisjeve elektrike, hidroizolimit duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë, duke siguruar papërshkueshmëri të plotë ndaj ujit dhe lagështisë. Në çmim përfshihen të gjitha materialet, gërmimi dhe transporti i dheut, transporti, puna dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e pozicionit.	copë	1.00	500.00 €	500.00 €
9.10	Furnizimi, transporti, montimi dhe lëshimi në punë i grupit të pompimit-pompa për sistemin automatik të ujitjes së parkut, i përbërë nga pompë zhytëse inox 4", me kapacitet minimal 5-6 m³/h dhe lartësi pompimi minimale 70 m, e pajisur me inverter (VFD) për ruajtjen e presionit konstant, mbrojtje ndaj punës pa ujë (dry-run protection), sensor niveli, mbrojtje termike të motorit, valvul moskthimi, manometër dhe të gjitha elementet përcjellëse për funksionim të sigurt dhe afatgjatë. Sistemi duhet të sigurojë presion të mjaftueshëm për funksionimin simultan të dy zonave të ujitjes dhe të jetë i projektuar për shfrytëzim të vazhdueshëm në ambiente të jashtme. Në çmim përfshihen të gjitha materialet, kabllot elektrike, pajisjet mbrojtëse, montimi, testimi dhe vënia në funksion e sistemit. "Pompa të jetë e prodhuesve të njohur ndërkombëtarë si Grundfos, Wilo, Lowara ose ekuivalente dhe të ketë garancion minimal 24 muaj nga prodhuesi.	cope	1.00	3,000.00 €	3,000.00 €
"Punëkryesi obligohet që para furnizimit me pajisje të paraqesë llogaritjen hidraulike të sistemit të ujitjes, duke dëshmuar debitin dhe presionin e nevojshëm në secilën zonë, si dhe përzgjedhjen e pompës përkatëse."					
				Shuma:9	7,596.00 €

10	Ndriçimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
10.1	Hapja dhe germimi i kanalit (0.3x0.7)m per shtrirjen e kablos se ndricimit publik, gypit, shiritit si mbushja me zhavor dhe kthimi ne gjendjen e me parshme	m'	200	1.00 €	200.00 €
10.2	Porosia dhe shtrirja e gypave PVC të brinjëzuar Ø 60 mm per vendosjen e kablllove te ndricimit	m'	240	1.00 €	240.00 €
10.3	Furnizimi transporti dhe vendosja e shiritit per tokezimFe/Zn 25x4 mm.	m'	240	2.00 €	480.00 €
10.4	Porosia dhe shtrirja e shiritit plastik vrojtues për ekzistimin e kablllove energjetik përgjat linjës, mbi kabëll.	m'	200	1.00 €	200.00 €
10.5	Porosia dhe shtrirja e kablllos për furnizimin e secilës shtyllë, prej Ormanit të grupit matës deri te shtylla e fundit, me kabëll PP00 2x16 mm2 Al komplet me papuçe dhe material tjetër të nevojshëm	m'	260	3.00 €	780.00 €
10.6	Gërmimi,punimi dhe betonimi i bazamentit/themeleve me dimensione 45x45cm h=60cm për shtyllat e ndriçimit L=4m. Klasa e betonit C25/30. Në këtë pozicion llogaritet edhe armatura dhe furnizimi/ punimi i kallëpve dhe largimi i tyre.	copë	20	20.00 €	400.00 €
10.7	Furnizimi dhe montimi I shtyllave të hekurta rrumbullakët prej çeliku 4 m së bashku me lirën. Materiali:Çelik i zinkuar dhe ngjyrosur me ngjyrë të zezë. Lyerja:Bojë elektrostатike (200 GRADE C) Lartësia:400cm Trashësia e shtyllës 4.0 mm Trashësia e pllakës bazë 9 mm Madhësia e bulonave të ankorimit 16 mm Gjatësia e bulonave të ankorimit 762 mm. Karkasa: Alumin i anodizuar, IP66, për ndriçim në lartësi, në shtylla duhet të jetë llogaritur edhe lira (mbajtësi trupave ndriçues) si në skic, klembert, siguresë FRA 16 A, kabëll PP-Y 3x2,5 mm² dhe material tjetër I nevojshëm në tërësi.	copë	20	350.00 €	7,000.00 €



10.8	Furnizimi dhe montimi Ndriçues:LED Fuqia : 30W Ngjyra :4000K - 6500K Fluksi :6800lm - 10200lm Lente:Asimetrike Jetëgjatësia:100 000 orë	copë	20	50.00 €	1,000.00 €
10.9	Izolimi me bitumen I bulonave dhe dadove për një shtyllë (4 copë), në pjesën e bazamentit për mbrojtje ndaj korozionit	copë	80	1.00 €	80.00 €
Shuma:10					10,380.00 €

Rekapitulimi		Shuma/Total (€)
1	Punët përgatitore	7,560.00 €
2	Punët e Gërmimit dhe nivelizimit	5,540.00 €
3	Punët e mbushjes dhe zhavorit	3,599.00 €
4	Kubëzat e betonit dhe shtruarja e betonit	45,200.00 €
5	Mobilari urban	14,700.00 €
6	Lojrat për këndin e fëmijëve	6,550.00 €
7	Dyshemeja prej gome	12,000.00 €
8	Gjelbrimi	10,160.00 €
9	Sistemi I ujitjes	7,596.00 €
10	Ndriçimi	10,380.00 €
TOTALI ME TVSH		123,285.00 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA - Parku 02					Fushë
Kosovë rr.Amir Elmazi					
1	Punët përgatitore				
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1	Matja dhe ruajtja e pikave gjeodezike, sipas Projektit.	komplet	1.0	2,520.00 €	2,520.00 €
1.2	Të bëhet pastrimi i terenit prej materialeve të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, si: heqja e shkurreve, heqja e gurëve, kubëzave, betoneve, rrethojave egzistuese dhe gjitha mbeturinave që ndodhen në sipërfaqe të terrenit të parkut. Njëherit materiali i grumbulluar parashihet të dërgohet/transportohet deri në deponi, sipas Menaxherit të Kontratës.	komplet	1.0	2,520.00 €	2,520.00 €
1.3	Sigurimi i vendpunishtes ne tërë perimetrin e parkut	komplet	1.0	2,520.00 €	2,520.00 €
Shuma1:					7,560.00 €
2	Punët e Gërmimit dhe nivelizimit				
		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1	Gërryerja e bazës së parkut në komplet sipërfaqet . Duhet të bëhet largimi i materialit, nivelizimi i saj, pra heqja e shtresës së tokës mes 20cm. Dheu i gërryer nëse është kualitativ duhet të planifikohet të shpërndahet mbrenda pozicionit të parkut, nëse për nga kualiteti është i dobët duhet të transportohet deri në deponi, sipas udhëzimeve të Menaxherit.	m ³	390.00	7.00 €	2,730.00 €
